



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenein 9.1.26(a)nenin 9.1.34 si dhe nenein 9.3.2,të Kornizes Kushtetues për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë të dates 15 Maj 2002.

Duke marr parasysh nenin 1 pika 1.7 paragrafi (d) të Rregullores nr.2001/19 mbi Degen e Ekzekutivit të institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Me qellim të qasjes dhe përkujdesjes institucionale,ndaj të gjithë atyre personave qe kan sakrifikuar dhe kontribuar në luftën e UÇK-së,Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr.17/2004
PËR
THEMELIMIN DHE FUSHËVEPRIMIN E DEPARTAMENTIT PËR
INVALIDET E LUFTËS,FAMILJET E DESHMORËVE DHE PËRSONAT E TJERË
QË KONTRIBUAN NË LUFTEN E UÇK-së**

Neni 1

Qëllimi i Udhëzimit Administrativ

1.1 Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ ,është rregullimi dhe përcaktimi i fushëveprimit,funksionimit,detyrave ,përgjegjësisve ,menagjimit ,drejtimit dhe çështjeve tjera me rëndesi të Departamentit për invalidet e luftës,familjet e deshmorëve dhe personat e tjerë qe kontribuan në luftën e UÇK-së.

Neni 2

Themelimi i Departamentit

2.1 Për mes këtij Udhëzimi Administrativ ,si strukturë organizative e veqant,në kuader të Ministrisë se Punës dhe Mirëqenies Sociale,themelohet „**Departamenti për invalidet e luftës ,familjet e deshmorëve dhe personat e tjerë qe kontribuan në luftën e UÇK-së**”.

Neni 3

Fushëveprimi

3.1 Fushëveprimi i përgjithshem i Departamentit për invalidet e luftes,familjet e deshmorëve dhe personat e tjerë që kontribuan në luftën e UÇK-së, është menagjimi,kordinimi,mbikëqyrja dhe administrimi i sistemit të sigurimeve shoqërore dhe të drejtave tjera të veqanta për personat qe me angazhimin e tyre,në çfarëdo forme ndihmuan për lirinë e Kosovës,apo u viktimizuan për këtë çeshtje.

Neni 4

Funksionimi

4.1 Për administrimin efikas dhe ndarjen e mirëfillt të aktiviteteve nga fushëveprimi i përcaktuar me lartë ,në kuader të Departamentit do të veprojn dhe funksionojn këto Divizione:

- **Divizioni i realizimit te të drejtave**
- **Divizioni i pagesave dhe**
- **Divizioni i teknologjisë informative**

Neni 5

Detyrat dhe përgjegjësitë

5.1 Detyrat dhe përgjegjësitë,nga fushëveprimi i Departamentit janë:

- Krijimi dhe zhvillimi i politikave aktive për një mirëqenie me të mire të invalideve,familjeve të deshmorëve dhe personave tjerë qe kntribuan në luftën e fundit.

- Mbeshtetja institucionale për të gjitha kategoritë e popullatës që kontribuan në luftën e UÇK-së
- Kordinimi i punëve nga fushëveprimi i Departamentit në raport me mekanizmat qeveritar dhe joqeveritar që janë të nderlidhura me këtë fushë.
- Krijimi i një baze të të dhënave kompjuterike për shfrytëzuesit potencial të pensioneve dhe benefiteve të luftës së UÇK-së.
- Administrimi, kontrolli, monitorimi dhe menagjimi i pensioneve të luftës dhe të drejtave tjera të veqanta për invalidet e luftës ,familjet e deshmorëve ,veteranet e luftës ,familjet e të zhdukurve,invalidet civil të luftës dhe kategoritë e tjera të populates që kontribuan në luftën e UÇK-së.
- Administrimi dhe mbikëqyrja e pagesave për pensionet dhe benificionet e tjera të luftës
- Organizimi i punës së komisioneve mjekësore për caktimin dhe vlersimin e shkallës së invaliditetit për invalidet e luftës dhe invalide civil të luftës .
- Shqyrtimi dhe vendosja sipas procedurave të ankimit ,në cilësinë e organit të shkallës së dytë të administratës.
- Mbikëqyrja e proceseve të zbatimit të Legjislacionit primar nga kjo fushë
- Hulumtimi i mundësive për sigurimin e donacioneve në rast të mungesës së mjeteve buxhetore .
- Bashkërendimi dhe bashkëpunimi i punës me Departamentet e tjera të MPMS ,veqmas me DAPK
- Kordinimi i veprimeve me pushtetin lokal përkitazi me përkujdesjen dhe ngritjen e mirëqenies së invalidëve të luftës së UÇK-së,familjeve të deshmorëve dhe personave tjerë që kontribuan në luftën e UÇK-së.

Neni 6

Drejtimi i Departamentit

6.1 Fushëveprimin e Departamentit për invalidet e luftës,familjet e deshmorëve dhe personave tjerë që kontribuan në luftën e UÇK-së e drejton dhe menaxhon Drejtori i Departamentit . Drejtori i Departamentit për punën dhe aktivitetet e Departamentit i raporton Sekretarit të Përhershem të MPMS.

Neni 7

Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizioneve

7.1 Autorizohet Drejtori i Departamentit për invalidet e luftës,familejt e deshmorëve dhe personave tjerë qe kontribuan në luftën e UÇK-së,qe në kohen sa më të shkurtër ta përgatit përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësiive të Divizioneve të këtij Departamenti dhe përshkrimin e vendeve të punës për Kryesuesit e Divizioneve.

Neni 8

Rregullimi i çështjeve tjera

8.1 Për zhvillimin dhe funksionimin efikas të Departamentit për invalidet e luftës ,familjet e deshmorëve dhe personave qe kontribuan në luftën e UÇK-së, Ministri përkatesisht Sekretari i Përhershem i MPMS,mund të nxjerrin akte tjera nenligjore ,të cilat duhet të jenë në pajtim me këtë Udhëzim Administrativ dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Neni 9

Hyrja në fuqi

9.1 Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi ditën e nenshkrimit ,nga Ministri i MPMS.

Prishtinë,dhjetor 2005

**Ministri i MPMS
Ahemt Isufi**
